

BARDHYL XHAMA
MIKESHAT E PËLLUMBIT
101 RRËFENJA TË ZGJEDHURA

BOTIMET TOENA

Bardhyl Xhama

Mikeshat e pëllumbit

101 rrëfenja të zgjedhura

Për fëmijë e prindër

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2018

Ky botim u mundësua nga  **CREDINS** bank

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo
Korrektore letrare: Petrina Ago
Përkujdesja grafike: Elida Stafa
Kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-235-70-1

© Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

Bashkëbisedim me lexuesit

Bardhyl Xhama, shkrimtar i mirënjohur për fëmijë e të rinj, “Mësues i merituar”, fitues i 12 çmimeve kombëtare dhe i “Çmimit të karrierës”, kësaj radhe paraqitet para lexuesve me librin “Mikeshat e pëllumbit”, në të cilin janë përmbledhur 101 rrëfenja, të përzgjedhura nga mbi 250 rrëfenja të botuara në pesë libra nga Shtëpia Botuese “Toena”.

Përmes stilit të shkurtër, nivelit të lartë artistik dhe gjuhës së pasur letrare, autori ka zbërthyer në këto rrëfenja për fëmijë (por dhe për prindër) vlerat edukuese të fjalëve proverbiale të thesarit popullor dhe të thënieve të mençura të njerëzve të shquar të botës.

Për vlerat e rrëfenjave të Bardhyl Xhamës kanë shkruar shumë studiues e shkrimtarë të njohur. E kanë quajtur: “Pasardhës të Kutelit”, “Babai i rrëfenjave”, “Mjeshtri i rrëfenjave” etj. Ndaj e shohim të arsyeshme që në krye të librit, kësaj here, të japim shkurt disa fragmente nga vlerësimet e shkrimtarëve dhe studiuesve të letërsisë për fëmijë, për vëllimet me rrëfenja të këtij autori.

Gjithashtu, për t’u ardhur në ndihmë lexuesve për të kuptuar mesazhet që përcillen në rrëfenjat e këtij vëllimi e që kanë vlera universale edukuese, do të rreshtojmë në vijim edhe disa nga fjalët e urta e thëniet e mençura, sipas kapitujve, mbi të cilat është mbështetur autori për të na dhënë shkurt e qartë moralin e rrëfenjave.

Vlerësime nga studiues e shkrimtarë

SKËNDER HASKO

Shkrimtari Bardhyl Xhama, vitet e fundit i është përkushtuar rrëfenjave, ku e ka gjetur më mirë veten dhe ka merituar vlerësimin e kritikës letrare e sidomos të fëmijëve, të cilëve u drejtohet.

Temat e rrëfenjave i ka qëmtuar kryesisht nga gurra e pashtershme popullore, nga fjalët e urta dhe nga ndodhitë e së kaluarës e të së sotmes, të cilat i ka shtjelluar shkurt, me gjuhë të pasur e të kuptueshme, me nivel artistik e karakter edukativ.

PANDELI KOÇI

Shkrimtari Bardhyl Xhama është afirmuar tashmë si një rrëfimtari i veçantë me përvojë. Duke ndjekur traditën e begatë të Mitrush Kutelit, ai deri tani ka botuar disa libra me rrëfenja të mirëfillta, në të cilat përmbledhen mbi 250 rrëfenja, pa përmendur këtu rrëfenjat e botuara në libra të tjerë dhe në organet e shtypit. Ato janë vlerësuar lart për nivelin e tyre artistik dhe, çka duhet theksuar, japin mesazhe edukative të spikatura të kohës, bazuar kryesisht te fjalët e urta dhe thëniet e zgjuara të njerëzve të shquar të botës.

MELAIM NELAJ

Shkrimtari Bardhyl Xhama ka spikatur me lëvrimin e një zhanri të shkurtër prozaik, atë të rrëfenjave, ku do të thoshim se ka gjetur veten dhe, madje, ka parë edhe suksesin, pasi ato janë mirëpritur nga lexuesit, aq sa nuk kanë munguar zëra kolegësh ta quajnë “Mjeshtëri i rrëfenjave” apo edhe “Babai i rrëfenjave”. Kjo jo vetëm për faktin se ai ka botuar disa vëllime

me rrëfenja, më shumë se çdo autor tjetër, por sepse ato shquhen për origjinalitetin dhe të veçantën e tyre, për motivet dhe gjetjet e goditura, për finesën e të konceptuarit dhe të shkruarit, për moralin e shëndoshë që bartin dhe mesazhet edukuese që përcejllin. Janë copëza të shkurtra letrare, në thelbin e të cilave qëndrojnë fjalë të urta të popullit tonë ose fjalë të mençura të njerëzve të mëdhenj të botës.

RIZA BRAHOLLI

Duke i lexuar këto rrëfenja, të bëhet sikur të ndjekin dy sy të dashur që të qortojnë, këshillojnë, por butë dhe me dashuri. Nëpër rreshta duket sikur fryn një fllad dashuror prej një mësuesi dhe gjyshi të mirë, që ai e zbulon pak nga pak. Në shenjë janë gabimet njerëzore, për të cilat, mençuria popullore, që në hershmërinë e saj, ka ngritur kode të vlerave shpirtërore, morale, shoqërore dhe estetike. Ai i drejtohet psikologjisë së tyre. Gjuha është e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, e kuptueshme, diku e hidhur e diku sarkastike, pa një simbolikë të ndërlikuar abstraguese, ndërlikime e ndërthurje të subjekteve. Rrëfimi është i ngrohtë, fjala e zgjedhur godet në zemrën e fëmijës. Marrëdhëniet ndërtohen në funksion të moralit të fjalës së urtë, që është dhe qëllimi i fundmë i ndërtimit të fabulës. Ai vjen nëpërmjet lojës dhe sintetizimit të veprimeve për të trokitur drejt vetëdijes së qenies, larg moralizimeve të thata...

XHAHID BUSHATI

Pavarësisht konfiguracionit të rrëfenjës... i paprekur mbetet "tharmi" i fjalës së urtë, të cilën autori e ruan me mjeshtri si një margaritar dhe, pa u ndier e pa kuptuar, ia "vendos" në "xhepin" e zemrës a të shpirtit si një mik i mirë lexuesit të vogël, për të kuvenduar gjithherë...

Kjo tregon se autori ia ka dalë aq mbanë, sa mik i rrëfenjës nuk është vetëm lexuesi i vogël, por edhe prindi i tij. Një fatlumësi të tillë nuk e ka çdo libër.

**Disa nga fjalët e urta dhe thëniet e mençura,
të cilat janë zbërthyer nga autori për të dhënë
mesazhet edukuese të rrëfenjave.**

PËR LIBRIN, SHKOLLËN, DITURINË

Ç'ke në xhep t'i marrin lehtë, ç'ke në tru, nuk t'i marrin dot.
Një njeri që humbet gjuhën e të parëve të vet, është i humbur.
I pasur bëhesh me dituri, jo me pasuri, i mençur bëhesh me
mendje, jo me moshë.
Më mirë me xhepin e boshatisur, se me mendjen e boshatisur.
E kam frikë atë njeri që ka lexuar vetëm një libër.
Ai që lexon një libër e mban shënime, është njësoj sikur e ka
lexuar dy herë.
Dua më shumë librin, se fronin mbretëror.
Kur bie guri mbi vorbë, themi “e mjera vorbë”; kur bie vorba
mbi gur, prapë themi “e mjera vorbë”!...
Mendja nuk është në masë të mjekrës.
Nuk jam budalla t'i di të gjitha.
Në libra gjendet gjithë dituria e botës.
Njeriu çmohet nga sa di e jo nga sa ka.
Libri është arma e të mençurit.
Shtëpia pa libra, si trupi pa shpirt.
Kush mbjell grurë, mendon për një vit; kush mbjell pemë, për
dhjetë vjet; kush mëson dhe edukon fëmijët, për njëqind e më
shumë vjet.

Libri i mirë është si një gur xhevahiri në gjerdanin e artë të kulturës botërore. I ditur bëhet kush përfiton sa më shumë nga shkëlqimi i tij.

Moti i ri të mos të të gjejë një mot më plak, por një mot më të mençur.

PËR ATDHETARIZMIN DHE TRIMËRINË

Paqja - kur bijtë varrosin etërit, lufta - kur etërit varrosin bijtë.
Njeriu vdes kur harrohet.

Mos e humb besën, se të humbet varri.

Pushka nuk varroset!

Armët e mbushura, faqja e bardhë...

Kush vdes për mëmëdheun, nuk harrohet kurrë!

PËR EMIGRACIONIN

Shit vendin e varrit e laj borxhin.

E vërteta, edhe tokën e shpon e del një ditë në dritë.

Dikush vjedh buallin e fshin buzët, ndërsa emigranti i mjerë masakrohet për një kokërr portokalli!...

Gota e lumturisë nuk duhet pirë asnjëherë me fund. Fundi ka gjithmonë llumra.

Balta mund t'i përlyejë diamantet, por nuk mund t'i kthejë në baltë.

Guri i rëndë, në vend të vet.

Premto më pak e bëj më shumë.

E dhëna e tjetrit është si e kruara e dhëmbit!...

Shpresa është ëndërr e të zgjuarve.

Shpresa - ilaç që nuk shëron e shton vuajtjet.

I duruari, i fituari.

Durimi është nëna e të mirës.

Mos puno vetëm me shat, por dhe me lopatë.

PËR MJEDISIN, FLORËN E FAUNËN

Liria vlen më shumë se gjithçka.
Kafshata e madhe të ngec në fyt.

PËR NDODHITË FËMINORE

Fjala është si bleta: ka brenda edhe mjaltin e ëmbël, por edhe thumbin helmues.

Jeta, është si vizatimi, që lë gjurmë ditë pas dite e vit pas viti, si lapsi mbi letër.

I pasuri, jep nga teprica, ndërsa i varfëri nga zemra.

Kush vjedh një vezë, vjedh dhe një buall.

Një lypës i shëndetshëm është më i lumtur se një mbret i sëmurë.

Një gram kujdes vlen më shumë se një kuintal ilaçe.

Atë që ta arrin dora, mos kërko të ta japin.

Kush lyp e ka një faqe të zezë, kush ka e s'jep, i nxin të dyja.

Degët bëjnë faj, trungjet qajnë.

Të gjitha idealet e botës, nuk vlejnë sa lotët e një fëmije.

Kush kërkon shokë pa të meta, mbetet pa shokë.

PËR PUNËN DHE FITIMIN

Qesh më mirë kush qesh i fundit.

Mate punën jo me atë që mbjell, po me atë që korr.

Çelësi që punon, s'ndryshket kurrë.

Dora me baltë, buka me mjaltë.

Shpresa të mban, po nuk të shpëton.

Mendja dhe duart të nxjerrin faqebardhë.

Po doni të ngopni një të uritur, i jepni një peshk. Po doni të ngopet tërë jetën, mësojeni se si të peshkojë.

Po dëshiron copën më të madhe, merr dhe shatin më të madh.

Bleta, para se të bëjë mjaltin, gatuan dyllin e përgatit hojet.
Fli pa darkë e zgjohu pa borxh.
Ai që bën një të mirë sot dhe e kërkon nesër, është njësoj si ai
që mbjell një fidan sot dhe e shkul nesër.
Mos pyesni se ç'ka bërë vendi për ju, mendoni se ç'bëni ju për
vendin.

PËR VIRTYTIN DHE VESIN

Kur mbreti vjedh një vezë nga fshatari i varfër, dihet që
ministrat e oborrtarët do të vjedhin të gjitha pulat e fshatit.
Gardhi kalbet e armiqësia mbetet.
Ujku e ruan qengjin nga dhelpra, që ta hajë vetë.
Keqardhja për gjërat që ke bërë në jetë, zbehet nga koha,
ndërsa keqardhja për gjërat që nuk ke mundur t'i bësh, është
e pashërueshme.
Gomarin, edhe me ar ta veshësh, veshët do t'i duken.
Kur s'kam ujë, pi ujë, se po të kisha ujë, do të pija verë.
Fitimi i keq, ta sjell të keqen në derë.
Gënjeshtra është si plaga, që edhe në u shëroftë, ta lë nishanin
për tërë jetën.
I ligu, edhe i vdekur, e lë të keqen prapa.
Ujku brenda, zihen për gardhin!
Një krimb than një lis.
Dhimbja që shkakton e vërteta, është më e lehtë se ajo e
mashtrimit.
Ndershmëria është si shkrepësja, hyn në punë vetëm një herë.
Qerosit, kur i doli një qime, çau festen që t'ia shikonin të gjithë.
Varfëria nuk ia zvogëlon fisnikërinë njeriut, por vetëm
pasurinë.
Kuvendin e prishin dy kategori njerëzish: ata që s'dinë e flasin
dhe ata që dinë e s'flasin.
Borxhi me borxh nuk lahet.
Dëgjo dy herë e fol një herë.

1.

LIBRI, SHKOLLA, DITURIA

Ç'ke në tru s't'i marrin dot

Fatmir Shkozës ia kishte ënda ta bënte të birin të shkolluar. Shiti dhe qetë e parmendës dhe e nisi djaln jashtë shtetit. Po ai, për katër vjet me radhë, në vend të Universitetit, bëri “shkollën e kontrabandistëve” dhe zuri pará të madhe.

U kthye në fshat i veshur si european, me hundë në qiell e mendje në diell.

- Hë, mor bir, ku e ke diplomën, - e pyeti i ati.

- Ja ku e kam, baba, - iu përgjigj me mburrje i biri dhe i tregoi pakot me kartëmonedha. - E ç'më duhej diploma, kur fitova kaq shumë?!

I hidhëruar sa më s'ka, i ati iu përgjigj:

- Gabove, bir, gabove rëndë! Paraja nuk të bën të mençur e të ditur, as të mirë e të dobishëm. *Ç'ke në xhep t'i marrin lehtë*, aq më tepër kur nuk janë fituar me ndershmëri. Ndërsa *ç'ke në tru*, more bir, *nuk t'i marrin dot*!

Humbe gjuhën, je i humbur

Ungrit baca nga bjeshkët, bëri rrugë të gjatë e arriti gjer në dhé të huaj. Një brengë ia rëndonte zemrën. Po mbushej një dhjetëvjeçar që i biri nuk qe kthyer në vendlindje. E dinte që punonte shumë, madje qe bërë i kamur. E ndihmonte dhe bacën për të përballuar jetesën.

Djali me nusen e pritën krahëhapur e me të gjitha nderet. Po plaku u mërzit, se nusja nga dheu i huaj nuk kishte mësuar ndopak gjuhën e tij e biseda bëhej me përkthyes.

Kur ia behën nga shkolla nipi me mbesën, baca u ngazëllye. Fëmijët iu hodhën në qafë dhe e pushtuan me ashk. Njiheshin vetëm nga fotografitë e shkëmbyera. Bacës, si rrallëherë, i bulëzuan lotët nga gëzimi.

Po kur plaku nisi t'i pyesë për shkollën, të dy vogëlushët u hutuan, ngritën supet si me komandë dhe hodhën shikimin nga i ati.

- Nuk e dinë gjuhën tonë, baba, - ia ktheu ai kokulur.

Bacës iu mblodh një lëmsh në zemër e iu trashën rrudhat e ballit. Në çast desh të ngrihej e të ikte nga sytë-këmbët. I biri ia kuptoi brengën dhe e ndali. Donte ta qetësonte, mbase dhe të shfajësohej. Po dhe bacën e kishte pikur malli.

Plaku, më në fund, i hodhi të birit një vështrim qortues dhe ia priti:

- *Një njeri që humbet gjuhën e të parëve të vet, o bir, është i humbur!... Duket sikur ka mohuar mëmëdheun!...*

*I pasur me dituri,
i mençur me mendje*

Sadush Doriu, në kohën e vet, ishte stanari më i pasur i fshatit. Kopeja e tij numëronte qindra dhen, që i bleu e i shumoi me të ardhurat që siguroi me mund. Po, kur u plak e nuk i punonin më këmbët e duart, ia la trashëgim të birit, Balanit.

Po Balani nuk pati diturinë e mençurinë e të atit. Kopeja me dhen nuk i shkoi mbarë. Prodhimet i mbeteshin pa shitur, të ardhurat u pakësuan.

I biri i Balanit, Guraliu, sapo kishte mbaruar filloren. I ati e mori në stan, se ia kishte nevojën. Mendonte se djali do t'ia dilte mbanë jetës duke mësuar zanatin e bariut. Por, kur ekonomia vazhdonte pa u ndalur të merrte tatëpjetën, Balani e shtrydhi mendjen e kujtoi porosinë që i kishte dhënë i ati para se të vdiste. I biri po rritej e do të vinte koha që të merrte në dorë kopenë. Po a ia dilte dot i paarsimuar, ashtu si ai vetë?! E shkëputi Guraliun nga bagëtia dhe e dërgoi në shkollë. Djali që i zgjuar dhe i ngjiti shkallët e shkollimit njëra pas tjetrës. Balani harxhoi dhe një pjesë të pasurisë dhe të birin e çoi në shkollë të lartë të studionte për veterinarin.

Kur Guraliu u kthye me diplomë e rezultate të shkëlqyera, Balani u bë me krahë. Ia dorëzoi bagëtitë e mbetura dhe i tha fjalët që ia kishte thënë i ati: *"I pasur bëhesh me dituri, jo me pasuri, i mençur bëhesh me mendje, jo me moshë"*.

- Unë, more djalë, nuk e zbatova porosinë e babait, ndaj dhe e firova pasurinë. Ti, tani, ke diturinë, ke dhe mençurinë, puno me mendje të kthjellët dhe kopeja do të shtohet e do të shumohet më shumë e më mirë se në kohën e gjyshit tënd... Hajde, pra, të qoftë e mbarë!...

Djaloshi buzëqeshi. I erdhi mirë që i ati, më në fund, i dha një porosi të zgjuar.

Dhe kështu, Guraliu i rregulloi punët, jo vetëm për ekonominë e familjes, por ndihmoi që dhe bagëtia e fshatit të vihej në rrugë më të mbarë, gjersa erdhi një ditë që atë e emëruan veteriner të gjithë krahinës.

Përgjigje e merituar

Adri Kona jetonte me gruan dhe pesë djemtë. Tërë ditën e ditës nxirrte gurë, duke thyer shkëmbinj me vare. Pastaj i shtypte e i bënte çakëll për të shtruar rrugën nga fshati në qytet. Kishte dhe disa rripa toke, që i punonte e shoqja me krahë dhe i mbillte me zarzavate. Mbante dhe shtatë a tetë kokë dele që kullotnin në tufën e përbashkët të fshatit.

I varfër ishte, po ndokujt nuk ia ndeu dorën. Dy djemtë më të rritur i çoi në shkollë të lartë. Të tretin në gjimnaz e dy më të vegjlit vazhdonin shkollën në tetëvjeçaren e fshatit.

Jeta ishte e vështirë. Të ardhurat të pakta. Lodhja rraskapitëse. E, megjithatë, burrë e grua i kishin dalë zot familjes. Lumturia e tyre më e madhe qe shkollimi i fëmijëve. Për këtë, ia vlente sakrifica.

Një ditë vere Adri Kona, si zakonisht, po punonte në rrugën e fshatit, duke thyer gurë e shtruar çakëll. Qe veshur me rroba pune e shollë lastiku të mbërthyera me tela. Në kokë mbante një kapelë të dalë boje nga dielli. Fytyra i qe skuqur flakë e djersët i rridhnin çurg. I lodhur tej mase, u ul mbi një gur, në hijen e një gëmushe dhe drodhi një cigare. E ndezi, e thithi disa herë me afsh dhe sikur u çlodh. Mendja i shkoi te djemtë. Ata mësonin shumë, madje qenë të dalluar.

Le të lodheshin ai dhe e shoqja, e ardhmja e fëmijëve i lumturonte, u jepte guxim, fuqi për të përballuar jetën.

Në këto çaste, iu afrua një nga fshatarët, thumbaxhi, gjysmanalfabet e pak i lehtë nga mendja. Kur e pa ashtu si të përhumbur e të djersitur me cigaren në buzë, i tha:

- Eh, more Adri Kona, si je katandisur!... Tërë jetën gurë do të thyesh?!... Gjithë rrugët ti do t'i shtrosh, a derëzi?!... Hiqi, ore, dy djem nga shkolla e të punojnë dhe ata, çoje njërin çoban në kope, fute dhe tjetrin këtu në rrugë, se të mbeti tërë jetën xhepi i boshatisur e shollat e grisura!

Adri ngriti kokën, e pa mirë e mirë atë që "ia qante hallin" dhe iu përgjigj:

- *Më mirë me xhepin e boshatisur, se me mendjen e boshatisur!...* Djemtë e mi do t'i bëj me shkollë, se ashtu e kanë të ardhmen të sigurt. Mendjeboshi s'ia qan dot hallin mendjeplotit...

Fshatari thumbaxhi iku kokulur. Përgjigjen e mori siç e meritonte.

Kam frikë nga ai që ka lexuar vetëm një libër

Utakuan dy shokë të vjetër. Kishin vite pa u parë. Biseduan për kohën e rinisë, për punën e hallet, shkëmbyen mendime mbarë e prapë për politikën, për grindjet e mosmarrëveshjet pa fund...

- Të ndërrojmë temë, - Lis Shega i tha Alush Dokut. - Në librari ka dalë ribotimi i romanit të Viktor Hygoit, "Të mjerët". Është shumë tërheqës... A e ke lexuar?!...

Alushi u rrudh për një çast, por iu përgjigj hapur.

- Unë nuk para merrem me libra, zoti Lis. Më kanë mjaftuar tekstet e shkollës... E di? Të them të drejtën, kam ca alergji nga librat... Më duket se shkrimtarët stisin ngjarje kot së koti... Ah, se desh harrova! Para shumë vitesh kam lexuar vetëm një roman: "Don Kishotin". Përralla me mbret...

- Vetëm një libër?!... - u habit Lisi. - Po a e di si thotë një shprehje latine? Dëgjoje: "*E kam frikë atë njeri që ka lexuar vetëm një libër...*". Ore, Alush, a e kupton se edhe ti po më tremb mua?!

Tjetri e vështroi me habi.

- Të tremb the?! Jo, ore. Unë s'jam gogol si ai Don Kishoti... Po hë, o Lis, pa ma shkoqit atë punën e trembjes.

- Ai që nuk lexon libra, mbetet i mangët. Po, po, i mangët, - nguli këmbë Lisi pak i nervozuar.

- Gjepura! - ia ktheu tjetri. - Pse, i mangët të dukem unë?!

Lisi u zu ngushtë. Ia ktheu me shaka dhe i buzëqeshi.

- Si të ta them..., i mangët fare mbase jo, po, ama, diçka të mungon... Ore, byrazer, dihet se në libra janë përmbledhur gjithë dituritë e botës. Dhe, një njeri që nuk përfiton nga dituritë e botës, domosdo që mbetet i mangët.

- Bota ime është bujqësia, zotëri! Për atë s'ma kalon kush. E thaj fare.

- Sa e vockël qenka bota jote, o mik..., - i tha si me shaka Lisi dhe qeshi.

Qeshi si me zor edhe Alushi... U ndanë pa e ditur në u morën vesh për çka biseduan. E, megjithatë, Alushi gjithë rrugës bluante në kokë fjalët që i tha Lisi: "E kam frikë atë njeri që ka lexuar vetëm një libër".

Dua më shumë librin, se fronin mbretëror

Fatos Gajtani mbaroi filloren në Dushkanin malor. Klasën e pestë erdhi ta ndiqte në qytet, te gjyshërit, se në vendlindje nuk kishte shkollë nëntëvjeçare.

Edhe pse pak i ndrojtur e fjalëpakë, djaloshi e filloi mbarë vitin e ri shkollor. Gjysh Arbeni përkujdesej për mbarëvajtjen e tij në mësim, ndërsa gjyshe Minushja e vishte njësoj si djemtë e qytetit, kujdesej për ushqimin e për gjithçka tjetër që i duhej Fatosit për t'u bërë i mbarë. Dhe ai e mori veten shpejt, u shkri me shokët e shoqet, u bë më i shkathët dhe u radhit ndër nxënësit e mirë të klasës.

Fatosi zbatonte me zell të veçantë orarin e studimit dhe i kryente detyrat me përkujdesje. Po gjyshi syçelë e i shkolluar, vuri re një të metë serioze të Fatosi... Ai nuk lexonte libra të tjerë, veç atyre shkollorë. Ndofta kjo që pasojë nga shkolla e fshatit...

Një ditë Arbeni i bleu nipit romanin “Një gjeneral kapet rob”, i përshtatshëm për moshën dhe i shfaqur dhe në ekranet e kinemasë e të televizorit. Ia dha ta lexonte. Fatosi u gëzua shumë, se e kishte parë edhe filmin.

Që atë pasdite, si mbaroi detyrat e shkollës, Fatosi u ul në minder dhe nisi të lexojë pa ndërprerje. Libri e tërhoqi dhe kur erdhi gjyshi nga kafja pas disa orësh, ai kishte arritur aty nga mesi.

- Bukur, nipçe, bukur! - i tha gjyshi dhe e përkëdheli kur e pa të kërrusur mbi libër. - Hë, a të pëlqen?!...

- Shumë, gjysh!... Më duket më mirë se në film... Edhe pak dhe e mbaroj!...

- Oj, oj!... Kaq shpejt?!... Po ndonjë shënim ke mbajtur?!... A m'i përmend dot personazhet?... Cilat janë shprehjet që të kanë pëlqyer?... Po përshkrimi më i bukur?...

Fatosi u zu ngushtë. Nuk qe i zoti të përgjigjej. Dësh t'i thoshte se kësaj radhe e lexoi shpejt e shpejt e mund ta lexonte përsëri ndonjëherë tjetër, por gjyshi sikur ia zhbiroi mendimin dhe i tha:

- Dëgjo, bir!... *Ai që lexon një libër e mban shënime, është njësoj sikur e ka lexuar dy herë.* Kështu thotë një fjalë e urtë e vjetër, o Fatos. Libri është shok i pandarë i jetës. E di ç'ka thënë Shekspiri, një nga shkrimtarët më të mëdhenj të botës?... Një shprehje të madhe: *"Dua më shumë librin, se fronin mbretëror"*.

Djaloshi i dëgjueshëm ua vuri veshin fjalëve të gjyshit. Fill pas një jave, kur mësuesja u dha një novelë për fëmijë si lexim jashtë klase, Fatosi mbushi një bllok të tërë me shënime dhe, në diskutimin që u bë në klasë, u vlerësua me notën dhjetë.

Rrëfejnë se Fatosi u bë një nga miqtë më të ngushtë të librit e madje filloi të shkruaj edhe tregime të shkurtra.

Guri dhe vorba

Në vatër bubullonte zjarri. Në të dyja qoshet e dhomës, përballë njëri-tjetrit, rrinin të menduar nënë Selvia me të birin, Besimin. Djali i sapolindur mbeti jetim. E ëma u lidh me të dhe e rriti me të këqija.

Sela, siç e thërrisnin shkurt nënën, shpupuriti me mashë prushin e afshët dhe lëshoi një ofshamë të thellë, që i doli si padashur nga shpirti i munduar.

Besi e pa me sy hetues. Fytyra e nënës po fishkej, po i nxiheshin gropat e syve e ca rrudha të holla i vijëzoheshin në ballë... Ai vazhdonte mësimet në klasën e shtatë dhe e ëma, e dobësuar kockë e lëkurë, rropatej arave për të mbajtur jetën gjallë. Ndjeu keqardhje të thellë!

- Po ç'ke, moj nënë, që psherëtin?! - e pyeti me zë të butë e dashamirës.

- E ç'të kem, o bir, - u përmend Sela nga mendimet. - Jam e lodhur, e këputur... Eh, e mjera unë, që s'ua dal dot më punëve!...

- Më ke mua, moj nënë! U rrita e tani bëhemi të dy bashkë... Pastaj... kërkojmë dhe ndonjë ndihmë!

- Po ku të përplasemi, o Besi! Askush s'na ndihmon dot. Fshatarët kanë hallet e tyre... Ne tani jemi si ajo puna e vorbës... Po, po. Tamam si vorba!

Besimi nuk po kuptonte pse qenë si vorba dhe bëri të habiturin.

- Ta tregon nëna atë punën e vorbës, - ndërhyri prapë Sela. - E thotë mirë fjala e urtë e popullit. Ja, dëgjoje: - *Kur bie guri mbi vorbë, o bir, themi "e mjera vorbë", se bëhet copë*

e thërri... Po edhe kur bie vorba mbi gur, o Besi, prapë themi “e mjera vorbë”!... Se njësoj është, ajo e mjera e pëson... Eh!... Ja, kështu dhe puna jonë.

- Ta lë shkollën, nënë, - ia ktheu Besi zemërthyer. - I punojmë bashkë ato pak ara që kemi... Do t'ia dalim nënoke, do t'ia dalim!...

Fytyra e Besit mori një pamje më burrërore dhe vazhdoi:

- Kështu, mbase, nuk do të bjerë as guri mbi vorbë e as vorba mbi gur!

Po nënë Selvia nuk u gëzua nga fjalët e djalit. Fytyra e saj u vërejt edhe më shumë. Madje, Besit iu duk e zemëruar. Dhe iu përgjigj:

- Kurrën e kurrës, bir!... Shkolla të çel sytë, të bën njeri të ditur... Ti e ke jetën përpara... Jo, bir, jo, kurrën e kurrës!... Shkollën nuk do ta ndërpresësh.

Besimi në atë çast u përplot. Nëna i dha dy mësimë: atë për vorbën dhe atë për shkollën. Dhe ai nuk iu nda shkollës, por, ama, u lidh edhe më ngushtë me nënën dhe e ndihmoi për të përballuar jetesën.

Më mirë xhepin bosh, sesa kokën zbrazur

Ilir Deti nuk i kishte mbushur të shtatëmbëdhjetat.
Varfëria e çoi në dhé të huaj të punonte e të jetonte.

E gjeti më në fund një punë dosido, si pjatararës në një gjellëtore. Punonte ndershmërisht, edhe jashtë orarit, edhe në detyra të tjera që i caktoheshin. Ndaj pronari e përkrahu dhe e paguante mirë.

Po Iliri kishte një merak të madh, merak që e brente përbrenda. Në vendlindje kishte ndërprerë shkollën e mesme për të shkuar në mërgim. Fillimisht, iu vu gjuhës së vendit pritës dhe e zotëroi aq mirë, sa vështirë ta dalloje që qe i huaj. Tani dëshira për të vazhduar shkollën e ndërprerë, iu ndez flakë.

- Zotëri, - iu drejtua një ditë pronarit. - Të jam borxhli për punën e pagën që më jep. Por do të lutesha të më lejosh të punoj e të shpërblehem për katër orë. Paradite dëshiroj të vazhdoj shkollën.

Pronari edhe u habit, edhe u kënaq. Të tjerë emigrantë dëshironin edhe punë jashtë orarit për të fituar diçka më shumë, ndërsa ky... i tha:

- Po, do të të mbetet xhepi bosh, more djalosh i mbarë!... Si do ta përballosh jetesën?

- *Më mirë me xhepin bosh, sesa me kokën zbrazur*, - u përgjigj aty për aty djaloshi.

Pronarin e kënaqi shumë përgjigjja e zgjuar e djaloshit dhe i krijoi të gjitha lehtësitë për të vazhduar shkollën. Iliri, kështu, po hapte një dritare të re për jetën.

Mendja s'është në masë të mjekrës

Qe mbledhur i tërë fshati nën hijen e rrapit, pranë burimit. Shteti kërkonte të dorëzoheshin armët që mbaheshin pa leje. Bisedat bëheshin herë të shtruarë e herë të rrëmbyera, herë të buta e herë të ashpra.

- A jemi me ligjin e për ligjin? - pyeti në një çast mësuesi i ri i fshatit dhe po vetë u përgjigj: - Atëherë t'i dorëzojmë armët, vëllezër e baballarë. Mbrojtjen tonë le t'ia besojmë shtetit...

Po Salush Salushi, me mjekrën një pëllëmbë e mustaqet një pashë, nuk e la të vazhdonte më gjatë e të shtjellonte mendimet.

- Armët nuk i dorëzojmë! - nguli këmbë mjekroshi. - Le të hidhet në qiell qeveria. S'kemi nevojë të na mbrojë shteti, mbrohem vetë.

Pastaj fshati u bëlesheli. Debati u ndez pro e kundër. Shumica përkrahu mësuesin e ri, por pati dhe nga ata që qenë të një mendimi me Salush mjekroshin.

U ngrit më në fund Luli Detari. Të gjithë heshtën. E njihnin për mençurinë dhe prisnin fjalët e tij për të davaritur mjegullën.

- Zotërinj! Mos shikoni kush flet, po dëgjoni e vlerësoni se ç'flet. Të madh nuk të bën mosha, po mendja. *Dhe mendja, dihet, nuk është gjithnjë në masë të mjekrës.* As të mustaqeve... Besoj se e kuptoni që të drejtë ka mësuesi i ri e jo Salushi me mjekër. E dimë dhe e kemi parë e provuar se armët në duart e njerëzve mbjellin vdekjen. Po ne jemi për jetën, apo jo?

Kaq u desh që bashkëfshatarët të kthjelloheshin. Dhe vendosën që t'i dorëzonin armët, të zbatonin ligjin.

Nuk jam budalla t'i di të gjitha

Besiana fluturonte nga gëzimi. Më në fund ia doli të pranohej në rrethin për mësimin e kompjuterit. Dhe jo thjesht si fillestare, se elementet e para i kishte marrë në kompjuterin që i kishte blerë i ati.

Vajza eci mirë dhe prindërit ndiheshin të kënaqur. Por, papritmas, Besit i lindi një dëshirë e re. E ftuan të regjistrohej në rrethin e teatrit, se, veç të tjerash, recitonte bukur. Edhe kësaj radhe e mori lehtas miratimin e prindërve. Tashmë, iu bënë dy rrethe.

Pas dy javësh, në ndeshjet e basketbollit midis klasave, Besiana, me trup të gjatë dhe e zhdërvjellët, u shqua jo vetëm në mbrojtje, por dhe për gjuajtje të sakta. Dhe, natyrshëm, e kërkuan në skuadrën përfaqësuese të shkollës. Kësaj radhe e ëma nuk qe dakord, ndërsa i ati ishte i lëkundur. Por, lutjet e vajzës, meqë edhe në mësimë shkonte mirë, i bindën.

Besiana kishte marrë vrull. Synonte të mësonte gjithçka, të merrte pjesë kudo. Më në fund prindërit vendosën t'ia ndërprisnin dëshirat e papërmbajtura, që mund të kishin pasoja në të ardhmen e saj. E thirri e ëma dhe i tha:

- Dëgjo, Besiana ime e dashur!... Bëju më e arsyeshme. Nuk mbahen shumë kunguj nën sqetull, se bien e bëhen copë... Më kupton? Mjaft e ke mësimin e kompjuterit, teatrin, basketbollin!... Madje dhe këto janë shumë.

- Po unë ia dal, o mami!... Edhe në mësimë nuk kam rënë!...

- Mund t'ia dalësh për pak kohë, por jo përgjithmonë. Diçka do të mbetet mangët në formimin tënd. Një dijetar i

madh i lashtësisë ka thënë: “Mos u angazho të dish çdo gjë, që të mos mbetesh gjysmak”. Dhe më qartë akoma e shpreh këtë një shkrimtar francez, kur thotë: “*Nuk jam budalla t’i di të gjitha*”... E qartë, bijë?!...

Besiana qeshi. Ishte vajzë e zgjuar dhe e kuptoi se edhe ajo po tregohej ca si budallaçkë, që donte të mësonte gjithçka në të njëjtën kohë.

Provë e vështirë

Babai u plak. Të tre djemtë po rriteshin njëri pas tjetrit. Ndaj do të provonte kush prej tyre ishte më i zgjuari, që ta caktonte si trashëgimtar e të kujdesej dhe për vëllezërit e tjerë.

Thërret të madhin.

- Merri këto pará, - i thotë, - dhe shko më bli ca mend në pazar.

U nis djali i madh e kërkoi në gjithë krahinën, zbriti dhe në qytet, por sa herë që kërkonte të blinte mend, njerëzit qeshnin me të dhe e merrnin për gjysmak.

Dhe kështu, pas çosa kohe, u kthye tek i ati i mërzitur e duarthatë.

- Shko ti, - i tha babai të dytit, - dhe më bli ca mend... Vec mos më eja duarzbrazur si yt vëlla!

U nis dhe ky si i pari. Brodhi sa brodhi gjithandej dhe, më në fund, iu duk se e gjeti se ç'kërkonte i ati.

- Babait i qenka tekur për tru të fërguar, - tha me vete. Shkoi te kasapi, bleu një kile tru dhe ia solli bashkë me paratë që i tepruan.

- Edhe ky s'paska gjë në rradake, - tha babai me vete. - Po le ta provoj dhe të tretin, më të voglin. E thirri dhe i dha të njëjtën porosi.

Ky i treti, i vërteti, si gatiti mushkën dhe i ngarkoi dy arka bosh, ra drejt e në qytet. U end për njëfarë kohe rrugë më rrugë, gjersa më në fund e gjeti shitoren që kërkonte. U fut brenda fytyrëçelur. Si u përshëndet me librarin, i zgjati paratë që i dha i ati dhe iu lut që t'i zgjidhte librat më të vyer. Ai, buzagaz, ia

mbushi të dyja arkat plot e përplot. Djali e falënderoi, ngarkoi mushkën e fluturoi në fshat.

- Urdhëro baba, - i tha të atit, - të kam sjellë dy arka me mend. Aq pará kisha, aq bleva.

- Hë, më të lumtë, mor bir! - e përgëzoi babai.

Ja, pra, ky qenka më i zgjuar nga të tre vëllezërit. I mblodhi të tre djemtë bashkë e u tha:

- Në këta libra, bijtë e mi, gjendet gjithë dituria e botës. *Mos harroni se njeriu çmohet nga sa di e jo nga sa ka. Libri është arma e të mençurit e nuk të lë kurrë të varfër.*

Shtëpia pa libra, si trupi pa shpirt

Agush Bala e kishte një brengë. E mbesa Rudina dhe nipi Eri, binjakë dhe nxënës në klasën e katërt, të urtë dhe të adhuruar nga të gjithë, kishin një mangësi të dallueshme. Nuk qenë të lidhur shpirtërisht me librin. Rrallë lexonin ndonjë libër artistik apo shkencor. Kjo ndodhte vetëm kur mësuesja ua jepte si detyrë dhe i kontrollonte e i vlerësonte me notë. Por edhe në këto raste, ata lexonin me përtesë, nga nevoja e jo nga dëshira.

E ëma, Mirka, dhe i ati, Edmiri, merreshin me tregti dhe puna u ecte mbarë. Kishin ndërtuar një vilë në periferi të qytetit dhe ishin ndarë nga trugu familjar. Për binjakët nuk kursenin asgjë. Rudina dhe Eri kishin secili dhomë më vete. Në to gjeje gjithçka që prindërit mendonin se ua bënte fëmijëve jetën sa më të mirë. Nuk mungonte për secilin televizori, kompjuteri, magnetofoni, videoja, radioja e lojërat kompjuterike.

Ama ndonjë raft me libra nuk kishin!... Paratë që u jepnin përditë prindërit e kamur shpenzoheshin për të blerë disqe me këngë e lojëra elektronike, akullore, ëmbëlsira e llojlloj çikërrimash, që rrallë u hynin në punë. Dhe fëmijët shpenzonin gati çdo ditë nga 200 lekë secili, lekë xhepi, siç i quanin ata. Oh, sa shumë libra të moshës mund të blinin me ato pará, sikur vetëm të hanin disa akullore më pak për çdo muaj, apo të përgjysmonin paratë që harxhonin për disqet me këngë e me lojëra elektronike!... Vetëm për një vit

mund të ngrihej një bibliotekë me mbi 200 libra. Bëjeni vetë llogarinë dhe do të bindeni për këtë.

Rudina dhe Eri shkonin mirë me njëri-tjetrin. Mësimet i vazhdonin në një shkollë private. Qenë të zgjuar e të bindur, por nuk arrinin më shumë se niveli i një nxënësi mesatar. Shkaku?!... Shpenzonin orë të tëra në televizor, në kompjuter dhe duke dëgjuar muzikë. Me prindërit takoheshin në mëngjes dhe vonë në mbrëmje, sepse ata qenë të zënë gjithë ditën me biznesin fitimprurës.

Gjyshi shkonte shpesh dhe i vizitonte. I këshillonte vazhdimisht për të lexuar libra. Por si atyre dhe prindërve u ishte fiksuar mendimi se tani ka ardhur koha e elektronikës, se njeriu sot mëson nga televizori, nga kompjuteri e nga informacioni i gjerë që përhapet me lloj-lloj mjetesh më shumë sesa nga librat!... Agushit i thyhej zemra, përpiquej t'i bindte për dobinë e pazëvendësueshme të librit, por nuk ia kishte arritur.

Në dhjetëvjetorin e Rudinës dhe të Erit gjysh Agushi shkoi me një dhuratë krejt të veçantë. Në oborrin e vilës qëndroi një furgon. Katër punëtorë zbritën prej tij tre dollapë biblioteke të punuar me dru arre, trashëgimi shekullore nga i ati, si dhe pesë kuti të mëdha kartoni të mbushura plot e përplot me libra...

... Pas disa ditësh, në vilën e Balajve, në njërën nga dhomat bri të fëmijëve, të kënaqte syrin një bibliotekë me libra të sistemuar më së miri nga Rudina dhe Eri. Prindërit po që po, por dhe të dy binjakët e mirëpritën dhuratën e madhe të gjyshit të ditur. Në raftet e dollapëve, tashmë, gjeje jo vetëm libra “të vjetër”, të botuar vite e vite më parë, të shkrimtarëve më të shquar të vendit e të botës mbarë, por dhe shumë libra të rinj për fëmijë, romane e novela, vëllime me përralla, tregime, rrëfenja me vjersha e humor të këndshëm, me fabula e kuriozitete shkencore. Ato i kishte përzgjedhur e blerë gjyshi për nipin e mbesën, që i donte si dritën e syve.

Rudinës e Erit u kishin mbetur në mendje fjalët e mençura të gjyshit ditën që ua solli bibliotekën. Mbesa ato i kishte regjistruar në magnetofon. Agushi u ishte drejtuar Edmirrit dhe Mrikës, por dhe binjakëve që dëgjonin tërë sy e veshë, dhe u kishte thënë:

- Ju punuat me zotësi e ndershmëri, u pasuruan, ndërtuat një vilë për merak, me oborr, lule e bimë dekorative. Bukur fort!... Po Ciceroni, një nga gojëtarët më të famshëm të Romës së lashtë, ka thënë: *“Shtëpia pa libra është si trupi pa shpirt”*. E, pra, biblioteka, librat, do t’i japin një shpirt të ri shtëpisë suaj. Në libra gjendet mendja e shpirti i shkrimtarit, gjendet shpirti i mijëra personazheve, me të mirat e të këqijat e veta, gjendet talenti dhe gjuha e përpunuar e njerëzimit, gjendet e njohura dhe e panjohura... Shkurt, shtëpia pa libra është si trupi pa shpirt. A jeton dot trupi pa shpirt?!...

Në fillim Rudinën e Erin i kënaqte bukuria e bibliotekës. Dalëngadalë filluan të shfletonin librat, të shikonin titujt e ilustrimet. Pastaj, ashtu si pa kuptuar, e pakësuan kohën që harxhonin në kompjuter e televizor dhe u dhanë më shumë pas librave, sidomos pas atyre që ishin për moshën e tyre.

Kaluan muaj gjersa binjakët u dashuruan me librin. Tashmë ata janë bërë jo vetëm lexues të rregullt, por nuk ka javë që të mos blejnë libra të rinj që u pëlqejnë. Biblioteka e tyre po pasurohet çdo ditë dhe, me siguri, në të ardhmen do të duhet një dhomë më e madhe për të nxënë librat që shtohen me shpejtësi.

Vila e Balajve, tashmë, ka një bibliotekë të pasur dhe lexues të rritur e fëmijë. Ajo është kthyer në një trup me shpirt.

Kush edukon fëmijë...

Sotir Gjika u kthye nga kurbeti me një mendim të qartë në kokë: kishte vendosur të çelte shkollë në vendlindje. Në disa fshatra të zonës ato ishin hapur e në gjithë vendin po mbinin si lulëkuqe.

Mirëpo Bregasi ishte fshat i varfër, vendësit e siguronin jetesën me mundim. Edhe fëmijët e tyre, sa rriteshin pak, ndihmonin prindërit në punë të ndryshme. Prodhimet qenë të pakta, se arat punoheshin me krahë e blegtoria nuk ecte mbarë, ngaqë kullotat ishin gjysmë të shkreta.

Sotiri kishte sjellë ca pará si dhuratë për ndërtimin e shkollës së re, po ato qenë të pamjaftueshme. Kështu që duhej të kërkonte edhe ndihmën e bashkëfshatarëve. Fillimisht bisedoi me të afërmit e me disa shokë të vjetër, që e mbështetën në nismën që kishte marrë. Po, ama, të gjithë i thanë se shumica e familjeve nuk qenë në gjendje të derdhnin pará për shkollën, ngaqë s'kishin ç'të jepnin.

U krijua një komision nismëtar. U bë dhe një takim me bashkëfshatarët. Atyre iu kërkuar që të jepnin diçka nga kursimet e pakta. Shumica premtoi ndihmë në të holla. Po disa të tjerë, edhe pse e miratuan çeljen e shkollës, e thanë hapur se qenë dobët nga ekonomia.

- Unë dy ngastra grurë mezi kam mbjellë, - tha një grua e ve. - Më duhet t'u shërbej, ta korr e ta bluaj dhe nuk e di në do të më mjaftojë të siguroj bukën për disa muaj...

- Rrojtjen e siguroj nga pemëtorja e vogël që kam, - tha një tjetër. - Jo vetëm që nuk më tepron gjë, po më duhet të marr dhe borxhe.

U ngritën e folën dhe të tjerë, hallexhinj e me pak të ardhura.

Sotiri, pasi i dëgjoi të gjithë me vëmendje, u ngrit e tha:

- Ua qaj hallin, vëllezër e motra! Por, ju lutem, ma dëgjoni një fjalë: *“Kush mbjell grurë, mendon për një vit; kush mbjell pemë, për dhjetë vjet; kush mëson dhe edukon fëmijët mendon për njëqind e më shumë vjet”*. Ja, kjo është e gjitha. E, pra, ne duhet të mendojmë edhe për një vit, edhe për dhjetë vjet, ama po të çelim shkollën, ku do të arsimohen fëmijët e fshatit, ne do të sigurojmë të ardhmen për dhjetëra e dhjetëra vjet, për një shekull e më tej. Mësimi dhe edukimi i fëmijëve do të lërë gjurmë në të gjitha brezat që do të vijnë.

Fshatarëve u pëlqeu fjala e Sotirit dhe, aty, bashkarish, vendosën se si do të ndihmonte secili për shkollën. Disa do të sheshonin vendin e do të hapnin themelet, disa do të grumbullonin gurë e rërë, të tjerë do të nxirrnin trarë, do të bënin tjegulla e kështu me radhë. Më të kamurit do të jepnin dhe pará, se duheshin edhe plot pajisje të tjera.

Thonë se ndërtesa përfundoi brenda tre muajsh e nuk mbeti asnjë fëmijë pa u ulur në bankat e shkollës. Tani ajo është kthyer në muze, ndërsa në Bregas është ngritur shkolla e re nëntëvjeçare, që nuk e ka shoqen në gjithë zonën.

Libri, si gur xhevahiri

Gjyshe Bardhoshja ishte marrë një jetë të tërë me librat. Në të ri, me profesion mësuese letërsie, librit nuk iu nda kurrë. Dhe jo vetëm se ia donte detyra, por mbi të gjitha ajo pati një lidhje shpirtërore me librin. Ai i hapi rrugë të reja, e bëri shkrimtare, kritike letrare, e mbrojti me njohuri nga të gjitha fushat e jetës. E njëjta mbeti edhe kur doli në pension. Në kohën e lirë nuk e shikoje kurrë pa libër në dorë, por ia gjeje dhe nën jastëk, se i ishte bërë zakon, që, para se të flinte, të lexonte diçka. Vetëm kështu e zinte gjumi rehat e shikonte ëndrra të këndshme.

Dashurinë për librin ua nguliti në zemër dhe në mendje edhe dy fëmijëve të saj, Dritës e Dijanit. Por nuk po i ecte mbarë me nipërit e mbesat!... Njëri syresh, Erisi i Dijanit, më i madhi ndër të katër, u lidh ngushtë qysh herët me gjyshen, lexoi dhe veprat që kishte shkruar ajo, e pëlqente dhe e shfrytëzonte bibliotekën e saj të pasur. Tashmë që ishte nxënës gjimnazi, shquhej ndër shokët jo vetëm në letërsi, por në të gjitha fushat. Lexonte veçanërisht librat fantastiko-shkencorë dhe ata me kuriozitete. Mori pjesë në një konkurs kombëtar në televizion dhe fitoi vendin e parë për njohuritë në fushën e shkencave matematikonoatyrore.

Veç nuk ndodhi kështu me dy vajzat binjake të Dritës dhe motrën e Dijanit. Sado që ishte munduar Bardhoshja dhe prindërit e tyre, nuk ia arritën që Dhurimja, Adriana e mbeska që kishte në shtëpi, Gëzimja, ta donin e ta nderonin librin siç ëndërronte gjyshja.

Kishte ardhur një kohë tjetër dhe vajzat rrallë i shikoje të lexonin ndonjë libër, veç atyre të shkollës. Ama mbërtheheshin me orë të tëra në televizor, në kompjuter, ose dëgjonin këngë në disqe, me zë të lartë deri në kupë të qiellit.

- Eh, moj mbeska të dashura!... - u thoshte gjyshja. - Jeni me fat që keni gjithë këto të mira, se në moshën tuaj ne nuk kishim as radio. Po jo tërë ditën e ditës, o çupa!... Kapni me dorë dhe ndonjë libër, se... nuk ka mbi librin, vajzat e gjyshes. Aty është gjithë dituria e botës!... Pastaj... librin e merr dhe me vete, e mban dhe në çantë, e mban dhe nën jastëk...

Vajzat nuk e kundërshtonin, shkonin në raftet e bibliotekës, i kërkonin ndihmë t'u zgjidhte nga një libër për fëmijë dhe, që të mos ia prishnin qejfin, nisin dhe e lexonin. Kështu një herë, dy herë, tre dhe sikur u mësuan. Jo se lanë televizorin, kompjuterin e këngët, po ama, u fut dhe libri në jetën e tyre.

Për Vitin e Ri, gjyshja u dhuroi të triave romanin “Harri Poter”, që sapo ishte përkthyer, me një shënim, që ajo e kishte formuluar vetë.

“Libri i mirë është si një gur xhevahir në gjerdanin e artë të kulturës botërore. I ditur bëhet kush përfiton sa më shumë nga shkëlqimi i tij.”

Moti i ri jo më pleq, po më të mençur

Një shqiptar i moshuar, xha Poli, kishte shkuar në Amerikë që në moshë të njomë, por që e lëvronte shqipen në majë të gjuhës, më tregoi këtë rrëfenjë për Fan Nolin:

“Shumë i nderuari, Fan Noli, gëzonte respekt të veçantë nga ne shqiptarët e Amerikës. Ore, nga shumë amerikanë që e njihnin... ishte i thjeshtë, i dashur e fjalë ëmbël me të gjithë ata që takonte. Dhe takohej me shumë shqiptarë të Bostonit, ku kishte dhe kishën. Se aty shkonim ne të krishterët çdo të diel për të kryer ritet fetare. Shkonin jo vetëm të moshuarit, po dhe të rinjtë. Se Fan Noli qe jo vetëm kryepriift, por dhe atdhetar, dijetar e shkrimtar i shquar.

‘E di ç’i ndodhi njëherë me disa të rinj?!... Ja, po ta rrëfej.

‘Ishte pragu i Krishtlindjeve dhe i Vitit të Ri. Ca djem shqiptarë kishin shumë dëshirë e kënaqësi të njiheshin më nga afër me Fan Nolin. Kur shkuan në kishë për festë, ia shfaqën dëshirën për t’i bërë një vizitë në shtëpi. Ai, tashmë i plakur, po i kthjellët nga mendja e i pastër nga shpirti, e pranoi pa mëdyshje kërkesën e tyre.

‘Dhe, aty nga ditët e fundit të vitit, të rinjtë, me një tufë me lule të freskëta, shkuan të bisedonin me të. E gjetën në tavolinën e punës, me libra e laps në dorë. I prit krahëhapur, jo si djem shkolle që ishin, por si t’i kishte miq e shokë të vjetër. Djemtë u ulën përballë tij dhe e ndjenë veten ngrohtë. Vetë Fan Noli i Madh ishte para tyre, si një monument i gjallë, mbresëlënës e fjalëzjarrtë. Siç ishte, Fan Noli!...

‘Biseduan gjatë. Të rinjtë pyetën shumë e mësuan ç’deshën nga jeta e puna e këtij njeriu të rrallë. Mirësjellja e Fan Nolit e shkriu akullin që zotëronte në fillim e biseda u bë më e gjallë e më e çiltër. Aty nga fundi i takimit, njëri nga djemtë i tha si i ndrojtur:

- I nderuari imzot Fan Noli!... Mos po lodheni shumë me gjithë këto libra që lexoni e me gjithë këtë punë që bëni përditë?... Ju tashmë jeni i moshuar dhe për dy ditë do të bëheni një vit më plak!...

- Ah, jo, djalosh! - ia ktheu Noli me buzëqeshje. - Jo një vit më plak, po një vit më i mençur!... Edhe për ju të rinjtë kështu është. Moti i ri të mos t’ju gjejë vetëm një vit më të mëdhenj, po një vit më të zgjuar, më të ditur... Se njeriu nuk matet nga mosha e nga masa e mjekrës, po nga mendja.

‘Djemtë u ndanë me Nolin me një ngazëllim në shpirt. Ata, jo vetëm që mësuan shumë për jetën e Fan Nolit, por morën me vete dhe shprehjen e tij, që ka ngelur si një fjalë e urtë:

‘Moti i ri të mos të të gjejë një mot më plak, por një mot më të mençur.’”

2.

Atdhetarizmi dhe trimëria

Lufta dhe paqja

Mësues Amanti jepte mësim në klasën e katërt të fillores. I ecte puna mbarë jo vetëm se e dashuronte profesionin e mësuesit, por edhe pse të gjithë nxënësit e klasës ecnin mbarë, e nderonin dhe i kryenin mirë detyrat.

Orën e mësimin të historisë së Shqipërisë, nxënësit e prisnin me më shumë kënaqësi. U kishte hyrë në zemër, ngaqë mësuesi shpjegonte me pasion, e ilustronte me pamje e dokumente të kohës, madje u tregonte dhe ndodhi e kuriozitete që nuk gjendeshin në tekst. Edhe fëmijët sillnin citate e tregonin ndodhi nga periudhat e ndryshme historike, sidomos nga luftërat për liri.

Duke bashkëbiseduar një ditë në klasë për periudhat e luftës e të paqes, mësuesi u dha nxënësve këtë detyrë shtëpie, në formën e një konkursi:

“Kush e shpreh sa më shkurt se cili është ndryshimi ndërmjet luftës dhe paqes, do të fitojë një pikturë të Skënderbeut”.

Për ditë me radhë nxënësit qenë vënë në kërkim, pyetën nënat e baballarët, gjyshërit e gjyshet, shfletuan libra me kuriozitete historike, vizituan muzeun e luftës. Secili gjeti një zgjidhje, apo më shumë. Përgjigjen ia dhanë mësuesit, të shkruar në fletoren e detyrave.

Në orën pasardhëse të historisë, mësues Amanti shpalli fituesin.

- Përgjigjet tuaja, të dashur nxënës, janë të lavdërueshme. Po njëri do të shpallet fitues dhe ajo është Redona. Me siguri jeni kureshtarë të dini përgjigjen e Redonës.

Meqë është me të vërtetë një gjetje interesante dhe e shkurtër, po e shkruaj në dërrasën e zezë.

“Paqja - kur bijtë varrosin etërit, lufta - kur etërit varrosin bijtë.”

U desh, pastaj, një bisedë e shtruar me pyetje e përgjigje për të zbërthyer e kuptuar domethënien e kësaj shprehjeje kuptimplotë që ka thënë babai i historisë, Herodoti.

Njeriu vdes kur harrohet

Armir Valbona njihej si trim e burrë zakoni. Po vdekja e mori para kohe. Ditën e mortit erdhën shumë miq e dashamirës t'i jepnin lamtumirën e fundit.

Shumëkush, si për t'u gjendur në bisedë, pyeste:

- Po, si vdiq?

- Si i ndodhi të ndjerit?...

I zoti i shtëpisë, edhe pse i mërzhitur, përgjigjej shkurt e me mirësjellje.

U ngrit më në fund një plak i moçëm, që mbante kryet e vendit, kur dhoma ishte plot e përplot, dhe i vuri kapakun këtyre pyetjeve që s'kishin të mbaruar. Tha:

- Mos pyesni si vdiq, o burra, po pyesni si rrojti. Armir Valbona nuk ka vdekur. *Njeriu vdes kur harrohet*. Bëmat e trimëritë tij për mëmëdheun do të jenë përherë midis nesh.

Trimi dhe vdekja

Thonë se vdekja është e pamëshirshme dhe thonë që nuk e njeh frikën. I rrëmben të gjithë, të mirë e të ligj, të bardhë e të zinj, të rinj e pleq, me radhë e pa radhë... I mbështjell me mantelin e saj të zi dhe i zhduk në errësirën e pëртејshme.

Po një ditë nga ditët edhe vdekja u tremb. Po, po, u tremb!

Një djalosh trim, në përleshje me armikun për mbrojtjen e trojeve amtare, kishte marrë plagë të rënda. Gjaku i rridhte çurg e sytë i qenë vagëlluar...

- Eh, i mjeri djalë! Është në çastet e fundit, trimoshi i nënës! - pëshpëriti mbi të e ëma e pikëlluar.

E dëgjoi vdekja dhe iu gjend pranë. Hapi mantelin e zi e u bë gati ta merrte e ta groposte në tokën e ftohtë.

- Merre!... Çpret? - i buçiti në vesh një zë i mistershëm.

Po vdekja nuk u ngut. Dëgjoi bisedat e njerëzve të mbledhur rreth shtratit të djaloshit për bëmat e trimëritë e tij të pashoqe dhe u frik.

- Jo, jo, nuk guxoj!... Ky qenka trim mbi trimat, - iu përgjigj vdekja zërit të mistershëm.

Mblodhi mantelin e zi dhe u zhduk tinës në guvat e saj të errëta.

Varrhumburi

Hyri vera e shkollat u mbyllën. Gjyshe Teuta donte ta kënaqte mbesën, Ajkunën, që kishte ardhur për pushime nga qyteti. Të dyja bashkë morën rrugën për në Arat e Qershive, në të dalë të fshatit.

Përmes një shtegu pyjor drurëndendur, zbritën buzë arës së tyre dhe u çlodhën pak në flladin e freskët, poshtë degëve kokrraplotë të qershisë. Gjelbërimi rretheqark ishte shpërthyes. Ajkuna vinte për herë të parë në pronën e familjes. Nuk po gjente të ngopur me natyrën mahnitëse të kësaj lugine, që përshkohej tejmbanë nga lumi gjarpërosh, poshtë kodrave me ara të mbjella.

Gjyshja mori shkallën e drunjtë në kasollen me kashtë përbri arës dhe e mbështeti mirë te trugu i qershisë. Ajkuna këtë priste dhe u ngjit mbi të si një ketër. Teuta e vërente me kureshtje e frikë përzier, ngaqë degët e qershisë janë të brishta e thyhen shpejt. Po vajza qëmtoi në pak sekonda qershitë e pjekura mirë dhe e mbushi shportëzën plot e përplot. Kështu bëri dhe disa herë të tjera, gjersa dy shportat e mëdha, poshtë, u bënë dëngëza.

Si shpëlaui mirë e mirë dy grushte me qershi te kroi aty pari, Ajkuna u kthye te gjyshja duarplotë. Tashmë, ishin gati të shijonin frutat e freskëta lëngëmblla e të bisedonin shtruar, siç e kishin zakon.

Ajkuna u bë kureshtare të mësonte emrat e arave të fshatit, rreth e qark. Gjyshe

Teuta, që kishte lindur e rritur në atë zonë, i dinte ato si Ajkuna alfabetin e shqipes.

- Ja, ajo lart nesh quhet Ara e Zoge, ajo më tej e Dane, më të djathtë të saj e Konde... Këtej majtas është ara e Varrhumburit, pastaj...

- Prit, prit, - e ndërpreu Ajkuna. - Si the, gjyshe, Ara e Varrhumburit?! Po më çudit! Pse ky emër, kur të tjerat emërohen sipas mbiemrave të fiseve?

- Ke të drejtë, bijë, të çuditësh... Është një histori e lashtë, aq e lashtë sa as gjyshi im që ma ka treguar nuk e ka jetuar vetë.

- Ma thuaj dhe mua, nënoke, - iu lut me përkëdhelje Ajkuna. - Jam shumë kureshtare ta mësoj.

“Sa e pabesueshme, - pëshpëriti me vete. - Varrhumburi!...”

- Ta tregon gjyshja, moj zogës, - iu përgjigj edhe Teuta ëmbëlsisht. - Veç shkurt, se po të ta tregoj hollësisht, në darkë kthehemi në shtëpi, - shtoi duke qeshur dhe filloi rrëfenjën:

- Ishin kohë të vështira. Vite lufte, vite pushtimi. Se gjithmonë i kanë lakmuar e sulmuar trojet tona, moj bijë. Gjithë burrat e gratë e krahinës u mblodhën e lidhën besa-besë. Lidhën besën, pra, të luftonin e ta çlironin vatanin. Nuk ka më të shenjtë se besa në luftë, bijo! Po a e di se ç’ndodhi?! Një nga fshati tradhtoi... Po, po, tradhtoi! U bë spiun, në shërbim të pushtuesve. E joshën me pará e me grada dhe u tregoi shtigjet nga të rrethonin luftëtarët. Po këtu, moj bijë, burra e gra qenë syçelë! I diktuan dhe u bënë qëndresë trimërore. Armiqtë jo vetëm u thyen e i përzunë përtej kufirit, po lanë edhe shumë të vrarë. Midis tyre që dhe besëthyeri ynë. As sot e kësaj dite nuk ia përmend njeri emrin. Besëthyeri, Varrhumburi, i thonë.

- Po pastaj, ç’ndodhi?! - pyeti Ajkuna, ende më kureshtare.

- Eh, pastaj! Shkurt, nuk iu bë asnjë ceremoni mortore... As nga familja që e turpëroi. I përgatitën një arkivol me dërrasa, e ngritën në krahë katër burra të fshatit dhe e varrosën natën, ja, atje tej, në bisht të arës së vet, larg syve të njerëzve. Po çudia ndodhi më vonë, moj çupë! Ishte mesi i vjeshtës. Varri i besëthyerit ishte ende i freskët, kur një natë qiejt